



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 580/5 Prot.

Tiranë, më 29. 05. 2025

V E N D I M

Nr. 130, Datë 29. 05. 2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 80 prot., datë 02.04.2025, të z. M. H., kundër Shoqërisë “L.” sh.p.k., në të cilën pretendohet diskriminim në vendin e punës për shkak të “gjinisë” dhe “racës”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, z. M. H., ka parashtruar në ankesë se : *Unë jam M. H., jam punonjës në restorantin “L.” në Pazarin e Ri, Tiranë, ku punoj si pjatolarës. Një koleg i ri që është punësuar si kuzhinier ka shfaqur sjellje diskriminuese ndaj meje. Ai ka bërë komente dhe shprehje me përmbajtje raciste para kolegëve të mi në restorant, duke më shkaktuar një dëm të madh psikologjik dhe një ndjenjë përjashtimi. Sjellja e tij më ka krijuar një ambient armiqësor dhe të pakëndshëm për mua në vendin e punës. Ai më tha: “Kjo është Shqipëria dhe është vetëm për shqiptarët. Çfarë po bën këtu? Nuk është vendi yt, largohu nga këtu.” Ajo që ai tha më vrau me forcën më të madhe se arma.*

Përfundimisht, ankuesi kërkon nga Komisioneri hetimin e rastit, konstatimin e diskriminimit dhe rregullimin e pasojave që vijnë si pasojë e tij.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijnë:

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, në lidhje me identifikimin e subjektit kundër të cilit kishte bërë ankimi,

si dhe në lidhje me shkaqet e pretenduara nga ana e subjektit ankues, lidhjes shkakësore ndërmjet trajtimit më pak të favorshëm dhe shkakut të mbrojtur.

Për këtë arsye, me shkresën nr. 580/1 prot., datë 07.04.2025, të Komisionerit, është kërkuar nga subjekti ankues që të saktësojë faktin kundër kujt subjekti e ka bërë ankesën, të dokumentojë shkaqet e pretenduara dhe të plotësojë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm.

Me email të datës 15.04.2025 nga ana e ankuesit është kthyer përgjigje dhe janë dhënë shpjegime në lidhje me informacionin e kërkuar nga ana e Komisionerit me shkresën nr. 580/1 prot., datë 07.04.2025.

Përsa më lart, nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte, Komisioneri filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, si dhe ato çështje që janë brenda afatit kohor për shqyrtim sipas parashikimeve të LMD-së.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Me shkresën nr. 580/2, datë 28.04.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Shoqëria “L.” sh.p.k, (*Restoranti*) për ankesën e bërë nga z. H., si dhe ka kërkuar aktet e poshtë cituara:

- Infomacion mbi pretendimet e ngritura nga ana e z. M. H.
- Informacion nëse jeni vënë në dijeni të rastit të pretenduar nga ankuesi dhe cili është qëndrimi i mbajtur nga ana juaj.
- Informacion nëse e ka adresuar ankuesi z. M. H., shqetësimin e tij pranë jush dhe çfarë masash janë marë nga ana juaj.
- Çdo informacion tjetër që ju do e gjykoni të arsyeshëm se do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështje.

Duke marrë shkas nga mungesa e përgjigjes zyrtare nga ana e Shoqërisë “L.” sh.p.k., (*Restoranti*), pas kalimit të afatit të parashikuar, me shkresën nr. 580/3 prot., datë 20.05.2025, iu kërkuua përsëri dërgimi i informacionit.

Me shkresën nr. 580/4 prot., datë 22.05.2025, u administrua pranë Komisionerit përgjigja e Shoqërisë “L.” sh.p.k., ku informon se: *Nga verifikimi i situatës së pretenduar për diskriminim nga z. M. H., ju sqarojmë se ka rezultuar një keqkuptim nga ankuesi për arsye se ai nuk e kupton shumë mirë gjuhën shqipe. Ju informojmë se aktualisht këta punonjës nuk kanë asnjë debat,*

konflikt qoftë dhe verbal. Aktualisht ata bashkëpunojnë rregullisht në aktivitetin që unë administroj.

Me e-mailin e datës 23.05.2025, inspektori i çështjes ia përcolli ankuesit materialin për njohje dhe për të paraqitur parashtrimet e tij në lidhje me qëndrimin e mbajtur nga punëdhënësi në këtë çështje.

Në vijim, ankuesi me e-mailin datë 25.05.2025, nëpërmjet një Deklarate, informoi Komisionerin se tërhiqet nga ankesa nr. 80, datë 02.04.2025, për arsye të arritjes së efektivitetit, pas ankesës drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, pasi situata është rregulluar dhe sqaruar për sa kishte pretenduar në ankesën e tij. Gjithashtu pohon se deklaratimet e punëdhënësit janë të sakta dhe nuk ka asnjë konflikt apo debat me personin e përmendur në ankesë.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”, KMD vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet përfundimi i procedurës administrative: “Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Njëkohësisht, në referencë të nenit 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”, Komisioneri deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 1, nenin 7, pika 1, neni 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, shkronja a) e nenin 33, pikat 9-10, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 80, datë 02.04.2025, të z. M. H., pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA